


Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ARRU kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtor është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtor është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtor është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar fushë ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në procesimin e pagesave.

Raporti i auditimit ka rezultuar me dy (2) rekomandime të reja. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.


Gjatë auditimit në shkurt 2025, u identifikuan gabime në pasqyrat financiare të vitit 2024 të ARRSHU-së të dorëzuara në thesar të Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve. Pas rekomandimeve të auditorit, menaxhmenti bëri korrigjimet e nevojshme dhe i ridërgoi pasqyrat e përmirësuara.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
20 06 2025			
Shif. Klasif. / Klasif. Kod / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Br. Prot. / No. Prot.	Br. Prot. / No. Prot.
05 47	1063	1	



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Për:	Kryetarin të Kuvendit të Republikës së Kosovës Hajrije Morina, Drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit
Kopje elektronike:	Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvendin e Kosovës Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2024.

Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 20.06.2025
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimit	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		<p>Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2024.</p> <p>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.</p>		

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2024 ishte 113,941€, prej tyre ishin shpenzuar 109,749€.

Çështja A1 - Vonesë në pagesën e faturave

- Gjetja** Sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.
- Gjatë auditimit në dy raste, faturat në vlerë totale prej 1,015€ nuk ishin paguar brenda afati ligjor prej 30 ditë, por me vonesë që varionte nga 9 deri në 24 ditë.
- Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike, mos planifikimi i parasë dhe vonesat në dërgimin e dokumentacionit nga OE për tu regjistruar ne sistemin e Thesarit si furnitor.
- Ndikimi** Si pasojë e këtyre vonesave në pagesa, ARRSHU mund të përballet me kosto shtesë të interesave dhe gjobave për vonesat e kërkuara nga palët e treta në përputhje me obligimet kontraktuale.
- Rekomandimi A1** Drejtori duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesa të faturave jo në përputhje me kontratë

- Gjetja** Kontrata publike kornizë me titull “Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e agjencive të pavarura” e lidhur në shtator 2024 në mes të Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe fituesit të kontratës, në seksioni II formulari i përshkrimit të cmimeve tregon sasia 36 muaj dhe çmimi mujor i shërbimeve është 1,601€.
- Gjatë auditimit, kemi vërejtur se në dy raste janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 3,982€ (2,066€ & 1,916€), ndërsa sipas kontratës shuma që do të duhej të paguhej për muajt tetor dhe nëntor ishte 3,203€, me një diferencë prej 779€ të paguar më tepër.
- Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të dobëta për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe mos komunikimit ne nivel te duhur më AQP.
- Ndikimi** Pagesa e faturave në vlerë më të lartë se sa vlera e kontraktuar paraqet një menaxhim jo të mirë të fondeve publike dhe shkakton humbje financiare.

Rekomandimi A2 Drejtori duhet të forcojë kontrollet e brendshme në fushën e financave për të siguruar që pagesat të bëhen në përputhje me kushtet kontraktuale dhe të rishikoj mundësinë e kthimi të shumës së paguar më tepër.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	475,806	450,152	345,255	348,588	360,236
Grante Qeveritare - Buxheti	475,806	450,152	345,255	348,588	360,236

Buxheti final është ulur për 25,654€ krahasuar me buxhetin fillestar, nga 475,806€ në 450,152€. Kjo ulje ka ndodhur kryesisht për shkak të uljes së granteve qeveritare.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	475,806	450,152	345,255	348,588	360,236
Pagat dhe mëditjet	230,362	232,208	232,208	236,335	241,443
Mallrat dhe shërbimet	138,941	113,941	109,749	109,026	114,828
Komunalitë	6,503	4,003	3,298	3,227	3,966
Investimet Kapitale	100,000	100,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:


-Buxheti final për pagat dhe mëditjet krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,846€, ndërsa shpenzimi ishte i njëjtë me buxhetin final;

-Buxheti final për mallrat dhe shërbimet ishte zvogëluar për 25,000€, krahasuar me buxhetin fillestar. Nga ky buxhet ishte shpenzuar 96%;

-Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,500€, , ndërsa shpenzimi ishte 82% e buxhetit final; si dhe

-Buxheti për investime kapitale ka mbetur i pandryshuar në 100,000€. Megjithatë, nuk është realizuar asnjë shpenzim në këtë kategori.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Buxheti final për të hyrat është i njëjtë me buxhetin fillestar 493,640€, ndërsa realizimi për vitin 2024 ka qenë 534,651€, apo 8.3% mbi vlerën e planifikimit, duke treguar një realizim më të lartë të të hyrave jo tatimore / taksat vjetore të licencimit krahasuar me vitet e kaluara.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	493,640	493,640	534,651	444,346	403,935
Të hyrat jo tatimore	493,640	493,640	534,651	444,346	403,935

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRSHU) ka identifikuar një (1) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. ARRSHU ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këtë rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, një (1) nga rekomandimet është mbyllur. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Drejtori duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomikë "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxha, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY




LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,



Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Emri Mbiemri: Hajrije Morina

Pozita: Drejtor

Data: 19.maj.2025

Nenshkrimi: _____



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.